ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 11(40-41)

Tiranë, 9/2/939

Shum i ndershem dhe
i Hirshem Imz Ungj,

Do të hapiti sigurisht
kur t'ju vijnë ime-shoqe dhe
Violeta, pa pritur. Qëllimin
do t'a mesoni: Po e dergonj
Violetën në Greqi, me që-
llim që të vazhdoje mësime
per Ekonomi Shtëpiake në
Οικονομική Σχολή që ësht
atje, siç jam marrë vesh
me kohë. Me këtë çështje
jam marrë që prej disa
muajsh dhe perandaj
s'kam patur as një që
t'ju shkruanjë letra. Kam
patur gajlë të madhe, se
me mbeti as andej, as andej,
kejo rupe dhe s'mbetej vetse
kejo udhë që mejtoj se do
t'i jetë e dobishme, se pas
2-3 vjet perfundon një
zotësi të mjaftë per këtu.
Tashi nga Hiresia e Juaj
besonj se do të kam
perkrahjen atnore, siç
kini zotuar per këtë. Na
duhet per këtë rast 100 franga
të paktën, gjë që besonj

se nuk esht e rende per juve
dhe qe miredashje e juaj nuk
do te m'a kursejë. Nuk do
t'ua ngarkoja kete barre,
por siç e dini, nuk kam se
ku te mbeshtetetem gjetiu per
~~te~~ u bere balle detyrave te
mia nga te renda, qe duhet
jo vetem t'i rrit te pese
femijet qe me ka falur Zoti,
po edhe t'u jap mesim,
t'i edukonj ashtu siç e
ndjenj dhe siç e kyp pozita
ime dhe koha e sotme. Be-
sonj se e kuptoni kete gjen-
djen t'ime, i nderuar lm Lengj.
dhe qe nuk do t'ju vijë rende
per kete bezdi, po perkundrazi
do të kenaqi se ju jepet
rast te beni nje miresi t'a-
fermit t'uaj më te singerte
dhe më nevojtar qe
s'ka dashur kurre t'ju
behet barre, por... e sjell
nevoja. Kete vajze me
pelqen t'a le ne kujdesjen
t'uaj. Nuk do duhen
më teper se 300 franga
ne vit. Shpresonj se do t'a
kem kete ndihme dhe do t'ju
jem mirenjohes.
Tere familja ime ju puthim doren.
Nuk di, kur do vini ketu? Po ju
presim per mbledhjet e Sinodhit.

Me nderime e mall
Vasili

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1164

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ